



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

UDHËZIM

Nr. 30, Datë 05.02.2010

**PËR VEPRIMIN E PËRBASHKËT TË STRUKTURAVE ZBATUESE TË
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE
NJERËZORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.8, datë 5.1.2002 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1083, datë 23.7.2008 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2008-2010, si dhe të dokumentit plotësues "Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit", me propozim të Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,

UDHËZOJ:

1. Strukturat kryesore përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara nga Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, mbështeten në përcaktimet e këtij Udhëzimi.
2. Strukturat kryesore përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, sipas rolit dhe rëndësisë që kanë në bashkërendimin e agjencive dhe veprimeve anti-trafikim, janë:
 - a. Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.
 - b. Task-Forca Kombëtare Anti-Trafik.
 - c. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz.
 - d. Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit.
 - e. Komitetet Rajonale Antitrafik.
3. **Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore**

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i ngritur me VKM-në nr.8, datë 5.1.2002, të ndryshuar, drejtohet nga Ministri i Brendshëm dhe përbëhet nga Zëvendësministri Përgjegjës të Ministrive të Linjës dhe titullari

i Shërbimit Informativ të Shtetit. Në mbledhjet e Komitetit ftohen të marrin pjesë edhe drejtues të lartë të Prokurorisë së Përgjithshme, të sistemit gjyqësor dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Komiteti dhe anëtarët e tij në zbatim të angazhimeve të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore janë përgjegjës në nivel politik për sektorët që ata drejtojnë. Komiteti vlerëson nivelin e zbatimit të Strategjisë, propozon dhe merr masat e mëtejshme për arritjen e objektivave të Strategjisë.

Anëtarët e Komitetit marrin masa për mbështetjen e strukturave të vartësisë dhe veprimet anti-trafik në fushën që mbulojnë në nivel qendror dhe vendor.

Komiteti zbaton urdhrat dhe udhëzimet e Ministrit të Brendshëm njëkohësisht edhe Kryetar i Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe mbështet Koordinatorin Kombëtar në veprimtarinë e tij për forcimin e luftës kundër trafikimit në njerëz.

4. Task-Forca Kombëtare Anti-Trafik:

- a. Përbëhet nga drejtues të lartë në nivel teknik me detyra kryesore në zbatimin e objektivave të Strategjisë në dikasterin ku punojnë, përfshirë përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Sistemit Gjyqësor, Komiteteve Rajonale Antitrafik, OJF-ve të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit në njerëz. Për çdo anëtar caktohet dhe një zëvendësues;
- b. Merr detyra për ndjekje nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si edhe merr çdo masë për zbatimin e tyre;
- c. Përgjigjet para anëtarëve të Komitetit Shtetëror në Ministrinë e Linjës mbi detyrat e realizuara;
- d. Bën propozime lidhur me nevojat për ndryshime të veprimeve që u takojnë atyre për t'i ndjekur, me qëllim realizimin me efektivitet të qëllimeve të Strategjisë dhe të aktiviteteve të saj;
- e. Task-Forca si rregull mblidhet 1 herë në 6 muaj nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar, por edhe më shpesh në rast se kërkohet;
- f. Çdo anëtar i Task-Forcës duhet të marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara dhe në rast zëvendësimi të tij duhet të njoftohet Koordinatori Kombëtar;
- g. Task-Forca është struktura kryesore përgjegjëse në nivel teknik për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si dhe për vlerësimin periodik të masave antitrafikim në vend, si në nivel qendror dhe vendor;
- h. Task-Forca raporton rregullisht tek Koordinatori Kombëtar mbi masat e realizuara dhe kërkon mbështetje prej tij dhe prej Komitetit Shtetëror për masa të nevojshme shtesë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Strategjisë;
- i. Secili anëtar i Task-Forcës është përgjegjës për fushën që mbulon dhe veprimtarinë e sektorit që përfaqëson. Ai raporton rregullisht çdo 3 muaj tek

Koordinatori Kombëtar, i cili nga ana e tij informon Ministrin e Brendshëm, njëkohësisht Kryetar i Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, për të gjithë punën e bërë.

5. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz:

- a. Drejtohet nga Zëvendësministri i Brendshëm, njëkohësisht edhe Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Koordinatori Kombëtar drejton veprimtarinë e Njesisë Antitrafik dhe atë të Task Forcës Kombëtare Anti-Trafikim. Koordinatori Kombëtar është i paanshëm dhe gjithëpërfshirës në koordinimin e veprimtarisë zbatuese të të gjithë aktorëve dhe agjencive shtetërore dhe joshtetërore me detyra dhe angazhime në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- b. Koordinatori Kombëtar përgatit raporte zyrtare për Qeverinë mbi situatën e trafikimit në vend, bën vlerësime për arritjet dhe propozon nevoja për t'u adresuar apo politika për t'u adoptuar;
- c. Koordinatori Kombëtar koordinon edhe ndihmën e donatorëve në fushën e anti-trafikimit dhe sigurohet që donacionet dhe projektet e tyre të orientohen në bazë të prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare Antitrafik;
- d. Koordinatori Kombëtar, përveçse me Qeverinë shqiptare, i ndan raportet e saj edhe me Qeveri dhe misione ndërkombëtare si dhe shoqërinë civile të cilat janë partnere aktive në Shqipëri në fushën e luftës kundër trafikimit në njerëz;
- e. Koordinatori Kombëtar ruan autonominë e tij në vlerësimin e situatës së trafikimit dhe këshillon Qeverinë mbi nevojat për ndërhyrje të mëtejshme;
- f. Koordinatori Kombëtar mbështetet nga Njësia Antitrafik e ngritur në vitin 2005, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.203, datë 19.12.2005. Kjo zyrë është pika qendrore për monitorimin dhe koordinimin e veprimeve/përpjekjeve antitrafik të të gjitha strukturave dhe aktorëve të tjerë publikë shtetërorë dhe jo-shtetëror (agjencive vendase dhe të huaja partnere);
- g. Njësia Antitrafik monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare Antitrafik, përgatit raporte periodike për situatën e trafikimit në Shqipëri. Njësia kryen rolin e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror (Ndërministror) të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Task-Forcës Kombëtare Antitrafik;
- h. Koordinatori Kombëtar mbikëqyr edhe funksionimin e Komiteteve Rajonale Anti-Trafik dhe i udhëzon ata në veprimtarinë e tyre;
- i. Koordinatori Kombëtar sigurohet që Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat e Trafikimit funksionon siç duhet;
- j. Koordinatori Kombëtar mbikëqyr funksionimin e Bazës së të Dhënave për Viktimat e Trafikimit dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj;
- k. Të gjitha njësitë zbatuese në qendër dhe në bazë duhet t'i referohen Koordinatorit Kombëtar për zbatimin e aktivitetit të tyre si edhe për ndihmë në rast nevoje.

6. Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit:

- a. Në këtë mekanizëm janë parashikuar detyra dhe përgjegjësi për Policinë e Shtetit, Shërbimin Social Shtetëror, Qendrat e licencuara për pritjen e viktimave të trafikimit, si dhe Shërbimet diplomatike shqiptare për identifikimin, asistencën, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në çdo rast në Shqipëri;
- b. Në zbatim të Marrëveshjes për Mekanizmin Kombëtar të Referimit të Viktimave të Trafikimit dhe Urdhrit të Përbashkët për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës anëtarët e kësaj strukture mbajnë përgjegjësi individuale për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara në këto dokumente;
- c. Autoriteti Përgjegjës është struktura që bashkërendon identifikimin, kthimin, pritjen, referimin për ndihmë dhe ri-integrimin e viktimave dhe/ose viktimave të mundshme të trafikimit. Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga Policia e Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Punëve të Jashtme-Drejtoria Konsullore, me nga 2 anëtarë për çdo institucion;
- d. Autoriteti Përgjegjës ka për detyrë të bashkërendojë punën me të gjitha strukturat, në Shqipëri dhe jashtë saj, për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, si dhe të sigurojë që të gjitha shërbimet e dhëna ndaj viktimës të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të viktimës dhe të marrin parasysh interesin më të lartë të saj;
- e. Autoriteti Përgjegjës ka për detyrë hartimin dhe dorëzimin e raporteve periodike pranë Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme, i cili nga ana e tij informon Ministrin e Brendshëm, njëkohësisht Kryetar i Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, për të gjithë punën e bërë;
- f. Autoriteti Përgjegjës ka përgjegjësi të regjistrojë dhe të raportojë periodikisht të dhënat për rastet e referuara të trafikimit. Kjo strukturë administron bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit dhe kujdeset për ruajtjen e tyre në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- g. Autoriteti Përgjegjës duhet të garantojë mbrojtjen e viktimave të trafikimit si dhe mban përgjegjësi për çdo rast të trajtuar prej tij;
- h. Autoriteti mbledhet në mënyrë periodike, si dhe për raste të veçanta, për koordinimin e punës mbi asistimin e viktimave të trafikimit, përfshi këtu edhe rastet e fëmijëve që shfrytëzohen në rrugë, si dhe raste transnacionale të referimit, duke u vënë në kontakt nga dhe me strukturat homologe në rajon;
- i. Autoriteti Përgjegjës është një strukturë ad-hoc, e ngarkuar me bashkërendimin e veprimeve për zbatimin dhe kryerjen e detyrave të Ministrive partnere në mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit.
- j. Autoriteti Përgjegjës ka nevojë për qëndrueshmëri të anëtarëve dhe mbështetje të eprorëve të tyre, si dhe për më shumë vullnet dhe veprim të përbashkët;

- k. Autoriteti Përgjegjës duhet të caktojë një sistem drejtimi me rotacion me intervale kohe 4 mujore, ku personi që ka drejtimin ka për detyrë të thërrasë dhe drejtojë mbledhjet e periudhës që mbulon;
- l. Autoriteti Përgjegjës mban takime periodike çdo 2 muaj, për menaxhimin e rasteve konkrete dhe sidomos të rasteve me nevoja specifike, siç mund të jenë problemet me shëndetin mendor, rastet me probleme të larta sigurie, etj;
- m. Anëtarët e Autoritetit Përgjegjës duhet të marrin pjesë detyrimisht në çdo mbledhje dhe secili prej tyre mban përgjegjësi individuale për pjesëmarrjen. Për çdo mungesë duhet të informohet Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- n. Autoriteti Përgjegjës kujdeset që pozita e të gjithë anëtarëve të tij të jetë e barabartë, duke punuar me përgjegjësi dhe mbi baza bashkëpunimi. Vendimet merren në mënyrë kolegjiale;
- o. Autoriteti Përgjegjës i paraqet Koordinatorit Kombëtar sugjerime dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të tij dhe të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, si dhe kur është e nevojshme propozon edhe shtimin e numrit të anëtarëve;
- p. Për mbledhjet që organizon, Autoriteti Përgjegjës njofton paraprakisht Koordinatorin Kombëtar, i cili merr pjesë në mbledhje ose cakton për këtë qëllim Drejtorin e Njesisë Anti-Trafik;
- q. Autoriteti Përgjegjës çmon dhe vendos vetë për masat e mbrojtjes që duhen marrë për viktimat e trafikimit si dhe për masat zbatuese për ta bërë më të mirë bashkëpunimin polici-qendra pritëse-shërbime konsullore;
- r. Autoriteti Përgjegjës raporton para Koordinatorit Kombëtar për rastet e trajtuara dhe vendimet e marra në çdo rast apo dhe për problemet e bashkëpunimit mes strukturave duke u përpjekur të gjejë së bashku me Koordinatorin mënyrën për zgjidhjen e tyre;
- s. Anëtarët e Autoritetit Përgjegjës, në emër të strukturave që përfaqësojnë, janë të vetmit persona që kanë akses në hedhjen e të dhënave për viktimat e trafikimit në *database*-in zyrtar të viktimave të trafikimit në vend. Të dhënat ruhen në bazë të ligjeve dhe rregullave për ruajtjen e të dhënave personale me qëllim shmangien e dëmtimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit nga publikimi i tyre. Përveç anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës, në bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit ka akses edhe Koordinatori Kombëtar dhe Drejtori i Njesisë Anti-Trafik.
- t. Një person në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar shërben si pikë kontakti për Autoritetin Përgjegjës.

7. Komitetet Rajonale Antitrafik:

- a. Me qëllim shtrirjen e punës mbrojtëse, parandaluese dhe intensifikimin e përpjekjeve antitrafik të qeverisë edhe në nivel vendor, me Urdhrin e Kryeministrit nr.139, datë 19.6.2006 janë ngritur Komitetet Rajonale Antitrafik (KRAT);

- b. Komitetet drejtohen nga Prefekti dhe në përbërjen e tyre janë të gjitha agjencitë shtetërore përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit në njerëz, si dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel vendor. Anëtarë të KRAT janë: Kryetari i Bashkisë qendër-qark, Drejtori i Shërbimit Social Shtetëror, Drejtori Rajonal i Punësimit, Drejtori i Policisë së Qarkut, Drejtori rajonal i SHISH-it, Drejtori Rajonal Arsimor dhe Drejtori i Shëndetit Publik. Në mbledhjet e Komitetit ftohen për të marrë pjesë edhe përfaqësues të Prokurorisë dhe të shoqërisë civile;
- c. Komitetet kanë edhe Tryezat Teknike, anëtarë të të cilave janë përfaqësuesit e strukturave të përmendura më sipër në nivel teknik, si dhe përfaqësues të Prokurorisë dhe të OJF-ve;
- d. Komitetet duhet të marrin masa për zgjerimin e tyre edhe me anëtarë të tjerë sipas rekomandimeve të Strategjisë dhe të sugjerimeve të dhëna nga Koordinatori Kombëtar;
- e. Komitetet punojnë me autoritetin e tyre për të parandaluar fenomenin e trafikimit, për mbrojtjen e fëmijëve, grave apo familjeve në pozitë të vështirë dhe të ekspozuar ndaj shfrytëzimit dhe trafikimit;
- f. Komitetet bëjnë vlerësime periodike për situatën e trafikimit në nivel qarku si dhe marrin masa për përmirësimin e situatës sipas nevojave;
- g. KRAT mbajnë mbledhje periodike sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.139, datë 19.6.2006, një herë në tre muaj. Për takimet e radhës njoftohet paraprakisht Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik. Në rast se nuk zhvillohen mbledhjet sipas këtij parashikimi, KRAT janë të detyruara të raportojnë për këtë tek Koordinatori Kombëtar. Koordinatori Kombëtar informon Ministrin e Brendshëm, i cili kërkon sqarime dhe marrjen e masave për personat përgjegjës;
- h. Për të gjitha mbledhjet e zhvilluara, KRAT mbajnë raporte të detajuara për të cilat informohet edhe Koordinatori Kombëtar;
- i. KRAT merren me trajtimin dhe referimin e rasteve konkrete për mbrojtjen ose parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve dhe grave në nivel vendor. Për këtë ngrihen Mekanizma Vendorë Referimi;
- j. KRAT mbi bazën e të dhënave të mbledhura prej tyre bëjnë një analizë të situatës së trafikimit të njerëzve në qark, si dhe përcaktojnë nevojat për ndihmë dhe ndërhyrje sociale në nivel qarku;
- k. Prefektura cakton një nëpunës, i cili mund të shërbejë si koordinator i Qarkut për KRAT;
- l. KRAT mund të shërbejnë edhe si bërthamë për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të qarkut, për shkak të përbërjes multidisiplinare që ata kanë;
- m. Në përbërjen e KRAT duhet të përfshihen Kryetari i Këshillit të Qarkut, Nënprefektët si dhe Drejtori Rajonal i Kufirit dhe Migracionit;
- n. KRAT koordinojnë punën e tyre me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve apo me Komitetet kundër Punës së Fëmijëve në Bashkitë/Komunat ku ato janë ngritur dhe shfrytëzojnë ekspertizën e tyre për ndërhyrje në këto drejtime;

- o.** KRAT-et shërbejnë si ura lidhëse ndërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar dhe pushtetit vendor për veprimin anti-trafikim. Ato i shërbejnë zbatimit të politikave të Strategjisë anti-trafik në nivel qarku;
 - p.** KRAT raportojnë tek Koordinatori Kombëtar periodikisht për mbledhjet e mbajtura, rastet e trajtuara dhe dokumentet e miratuara;
 - q.** Koordinatori Kombëtar njeh dhe respekton autonominë e veprimtarisë së KRAT për anti-trafikimin në qark, por kujdeset që veprimet e ndërmarra të vijjnë në përputhje me qëllimet e strategjisë;
 - r.** KRAT punojnë në partneritet të vërtetë me shoqërinë civile, duke i ftuar organizatat në mbledhjet e KRAT dhe duke mbështetur veprimtarinë e tyre.
- 8.** Me zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen të gjitha strukturat përgjegjëse të angazhuara në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

LULZIM BASHA

Zëvendësministre e Brendshme:

Znj. Iva ZAJMI

Sekretari i Përgjithshëm:

Z. Etion KAPEDANI

Drejtori i Shërbimeve Juridike:

Z. Sokol SHETI

Drejtoreshë e Njesisë Antitrafik:

Znj. Irena TAGA

Përgjegjësi i Sektorit të Përgatitjes së Akteve:

Z. Ervin ÇOLLAKU

Koordinator në Njësinë Antitrafik:

Z. Milaim DEMNUSHAJ

Specialist në DSHJ:

Z. Ergys GASHI; dt.29.1.2010